

NOTË INFORMUESE

Mbi kërkesën për procedim disiplinor me masën ‘Ulje page në maën 40% për 1 vit’, për magistratin K.Ll.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor ndaj magistratit K.Ll., prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, bazuar në ankesën e një qytetareje, të paraqitur përmes formularit online në faqen e ILD-së, për zvarritje të hetimit të procedimit penal dhe hetuar për shkelje disiplinore të parashikuar në pikën 1, shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, neni 102 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë konkludoi se:

- Nga ana e prokurorit K. Ll. janë ndërmarrë veprime dhe mosveprime, të cilat kanë të bëjnë me mospërmbyllje të pajustificuar të funksioneve gjatë hetimit, duke sjellë zvarritje të pajustificuar të akteve procedurale, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga ana e magistratëve.
- Nga ana e prokurorit nuk janë mbajtur në konsideratë detyrat e lëna nga gjykata dhe kryerja e tyre brenda një afati optimal.
- Mosveprimet e prokurorit janë kryer me faj me dashje direkt, duke mos përmbyllur detyrat e lëna nga gjykata, duke lënë pa veprime dosjen hetimore për një periudhë mbi 2 vjeçare, e duke e çuar ndjekjen penale në parashkrimin e saj.
- Si pasojë e shkeljes disiplinore të kryer nga ana e magistratit subjekt hetimi disiplinor është cënuar prestigji i figurës së prokurorit, si dhe është cënuar besimi i publikut të drejtësia.
- Sjellja e papërshtatshme nuk shtrihet vetëm tek magistrati subjekt hetimi disiplinor, por rrezikon të ndiqet si shembull nga magistratë të tjerë, si dhe krijon terren për sjellje të papërshtatshme dhe në raste të tjera të ngjashme.
- Magistrati nuk ka masë disiplinore për një shkelje disiplinore të mëparshme në fuqi, si dhe nuk ka kryer shkelje tjetër disiplinore.

Raporti hetimor i ILD vlerëson se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e prokurorit K. Ll., përbëjnë “Shkelje të rëndë disiplinore” dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë, marrjen e masës disiplinore “*Ulje e përkohshme e pagës*” në masën 40 % për një afat një vjeçar ndaj prokurorit K.Ll., parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “c” dhe neni 108 i ligjit “Për statusin”.